



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE			
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. jedinica Org. Unit	01	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8961
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data: Datum: Date:	22. 11. 23
PRISHTINË / A			No. 2

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Environment Spatial Planning and Infrastructure

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm me vendimin numer protokoli 8362/2023 të datës 01.11.2023, në përbërje Avdi Kamerolli-kryesues, Lendita Osaj-anëtare dhe Naser Afizi-anëtar, lidhur me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për iniciimin e procedurës disiplinore me shkresën nr.prot ndaj nëpunësit civil Nexhat Krasniqi – Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, në bazë të paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 59, nenparagrafit 2.7 të paragrafit 2 të nenit 57, nenparagrafit 7 të paragrafit 4 të nenit 56, të Ligjit për Zyrtar Publik nr.08/L-197, nenin 97 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe paragrafët 5 dhe 6 të nenit 12 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 Për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, merr këtë:

V E N D I M

z.Nexhat Krasniqi i Shqiptohet masa disiplinore, largim nga shërbimi civil.

Arsyetim

Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI, Izedin Bytyqi, ka inicuar procedure disiplinore kundër z.Nexhat Krasniqi me, shkresën me nr.prot.8903, të datës 20.11.23 pas këtij iniciimi, Komisioni Disiplinor u mbledhë me datën 21.11.2023, i cili e shqyrtoj dhe vlersojë iniciimin e procedurës disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësisë të punës nga nëpunësi civil z.Nexhat Krasniqi i cili aktualisht është i punësuar në Ministri të Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukture me aktemrim si Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, pas shqyrtimit dhe vlersimit të iniciimit të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor erdhë në përfundim se kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore është e bazuar, dhe kjo kërkesë është bërë duke u mbështetur në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 59 të Ligjit për zyrtar publik nr.08/L-197.

Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës me datën 03.11.2023, ndaj z.Nexhat Krasniqi, zyrtar i MMPHI e ka vendosur në listen e sanksioneve që përfshijnë ndalesën për hyrje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me arsyetimin se i njëjti është i përfshirë në korrupsion të madhe.

Duke pasur parasysh se z.Nexhat Krasniqi ka qenë i dënuar nga Gjykata kompetente si ish zyrtar i prokurimit në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë për korrupsion, konsiderojmë se kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga aspekti i përgjegjësisë disiplinore dhe për këtë duhet të shqiptohet masa disiplinore



sepse kjo në fakt paraqet edhe shkelje të përgjegjësisë dhe të detyrave të punës dhe është shkelur nenparagrafi 7 i paragrafi 4 i nenit 56, sjellje e papërshtatshme që demton reputacionin e shërbimit civil nga z.Nexhat Krasniqi.

Duke i pasur parasyshe raportet speciale në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, konsiderojmë se kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga aspekti i përgjegjësisë disiplinore dhe shqiptimit të masave disiplinore sepse kjo paraqet shkelje të rënda të detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara me ligjin nr.08/L-197 për zyrtar publik, konkretisht me nënparagrafin 7 të paragrafit 4 të nenit 56, sjellje të pa përshtatshme që demton reputacionin e shërbimit civil.

Duke u bazuar në Ligjin për Zyrtar Publik nr.08/L-197 dhe vlersimit të shkresës inicuese, Komisioni Disiplinor i MMPHI, erdhë në përfundim se janë shkelur rregullat e shërbimit civil si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 57 të Ligjit për Zyrtar Publik nr.08/L-197, shqipton masen disiplinore, largim nga shërbimi civil, për z.Nexhat Krasniqi sepse i njejtë e ka dëmtuar reputacionin e shërbimit civil dhe ka bërë sjellje të pa përshtatshme.

Pas analizimit dhe vlersimit të shkresave të lëndës, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Komisionit
Avdi Kamerolli

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Kabinetit të Ministrit;
- Nexhat Krasniqit;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Menaxherit të Personelit;
- Arkivit.